**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE**

Datë 16.07.2026

**RAPORT VENDIMMARRJEJE**

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2,433,796 (DY MILIONË E KATËRQIND E TRIDHJETË E TRE MIJË E SHTATËQID E NËNTËDHJETË E GJASHTË) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI EDEN-ECOLOGICAL DEVELOPMENT THROUGH FARMING FOR ENHANCING THE URBAN ENVIRONMENT, PROGRAMI INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027).**

**Baza ligjore:**

Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji nr. 65/2022, "Për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)", Ligji nr. 8/2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, për programin e bashkëpunimit (Interreg VI-A) IPA Itali–Shqipëri–Mali i Zi (Adriatiku Jugor) 2021-2027", Udhëzimit nr. 10, datë 12.07.2024, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmjet Partnerit udhëheqës së Projektit Bashkia Konversano/Municipality of Conversano (Itali) dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 01/09/2025, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Turizmit për alokimin e fondeve të parafinancuara nga projekti EDEN - Ecological Development through farming for enhancing the urban Environment (Zhvillim Ekologjik përmes bujqësisë për përmirësimin e Mjedisit urban), programi i BE-së Interreg IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027),

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 2,433,796 (dy milionë e katërqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, të ardhura si parafinancim nga fondet e programit Interreg IPA SOUTH ADRIATIC, Projekti EDEN, me kod produkti G107009, sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

| Gr. | Kap. | Programi | Llog. Ekon | Kodi i programit | Kodi i institucionit | Emri i institucionit | Emërtimi i projektit | Kodi i projektit | Fondi në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2 | Arsimi bazë përfshirë parashkoll-orin | 231 | 09120 | 2107001 | Bashkia Durrës | Projekti EDEN | G107009 | 2,433,796 |

2. Ky fond do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për zhvillim të aktiviteteve për vitin 2026 e në vazhdim, si: ekspertiza të jashtme dhe shërbime për takime lokale dhe ndërkombëtare, udhëtime jashtë vendit, materiale promocionale, kancelari dhe përkthim/noterizim.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Buxhetit, si dhe Drejtoria Ekonomike.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Fondi i Interreg IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027).

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Buxhetit, si dhe Drejtoria Ekonomike.

**Impakti social/grupet që preken:**

Banorët e Bashkisë Durrës.

**A është objekt konsultimi:** *(PO/JO)*

*JO.*

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mblodhë më datë 16.07.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 4 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetari i mbledhjes hapi për shqyrtim pikën e rendit ditës nr. 4

Të propozohet në mbledhje ishin dakort në parim për ta kaluar për votim në Këshillin bashkiak Durrës.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- ________________________________

**Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave**

| | | |
|---|---|---|
| Kryetar | Rolant Xhelilaj | PRO |
| Zv/Kryetar | Erzen Laçi | |
| Sekretar | Hekuran Markola | PRO |
| Anëtar | Jonada Mamo | PRO |
| Anëtar | Alfred Mullaraj | PRO |
| Anëtar | Kastriot Xhongoli | PRO |
| Anëtar | Silvana Agasi | |
| Anëtar | Dritan Burgija | |
| Anëtar | Jonuz Myshketa | |
| Anëtar | Xhojana Gjineci | |
| Anëtar | Kontjana Kuçi | |